



**Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo**



**Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi**

R R E G U L L O R E
P Ë R
K O M P E N S I M T Ë P A G Ě S P Ě R I S H
Z Y R T A T A R Ě T E L A R T Ě T Ě K O M U N Ě S

Në pajtim me nenin 12.2 pika c) dhe d) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me datën 15.07.2011, miraton:

R R E G U L L O R E N

PËR KOMPENSIM TË PAGËS PËR ISH ZYRTARËT E LARTË TË KOMUNËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore rregullohet kompensimi i pagës për ish zyrtarët e lartë të Komunës së Gjilanit, pas skadimit të mandatit, të cilët mbesin pa u sistemuar në vendet përkatëse të punës për shkak të rrethanave të parapara me këtë rregullore.

Neni 2

Zyrtar të lartë komunal në kuptim të kësaj rregulloreje konsiderohen: Kryetari i Komunës, Nënkyetar i Komunës, Kryesuesi, Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe drejtorët e drejtorive të Komunës.

II. DISPOZITAT E VEQANTA

Neni 3

1. E drejta e kompensimit të pagës zyrtarëve të lartë komunal nga neni 2 i kësaj rregullore u takon në rastet në vijim:
 - 1.1. nëse pas skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur ose emëruar nuk janë sistemuar në ndonjë vend pune;
 - 1.2. nëse gjatë ushtrimit të mandatit të zyrtarëve të lartë komunal për shkak të paaftësisë së tij shëndetësore nuk është në gjendje që në mënyrë të përhershme ta ushtroj funksionin e tij;
 - 1.3. nëse gjatë ushtrimit të mandatit, zyrtari i lartë komunal vdes, e që familja tij nuk ka burime financiare.

Neni 4

1. E drejta e kompensimit të pagës për ish zyrtarët e lartë të komunës dhe ish anëtar të kuvendit të Komunës u takon që nga data e përfundimit të mandatit në funksionin në të cilin janë zgjedhur ose emëruar e deri në sistemin e tyre në ndonjë vend të punës, e jo më gjatë se katër vite.
2. E drejta e kompensimit për ish zyrtarët e lartë të komunës për shkak të paaftësisë së tyre objektive për ta ushtruar funksionin fillon nga dita e paraqitjes së paaftësisë së tyre, e vlen deri në fillimin e realizimit të hyrave financiare nga ndonjë burim tjetër, e jo më gjatë se një vit.

Neni 5

1. E drejta në Kompensimin e pagës prej 70% të pagës bazë i takon ish Kryetarit të Komunës, Nënkyetarit të Komunës, Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës.
2. E drejta në Kompensimin e pagës prej 70% të pagës bazë me kompensim i takon ish anëtarit të Kuvendit të Komunës.

Neni 6

Mjetet financiare për kompensim e pagës sigurohen nga buxheti i Komunës.

Neni 7

1. Ish zyrtari i lartë i Komunës, mund të heqë dorë nga drejta e realizimit të kompensimit të pagës.
2. Të drejtën e kompensimit nuk e gëzojnë zyrtarët sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje të cilët nuk kanë ushtruar funksionin në të cilin janë zgjedhur ose emëruar në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 8

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje do të jenë në fuqi për derisa nuk nxirret ndonjë ligj apo akt tjetër nënligjor që rregullon këtë çështje.
2. Për zbatimin e kësaj rregullore, Komuna parasheh mjete me projekt – buxhetet për vitet vijuese.

Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe fillon të zbatohet prej 1 janarit të vitit 2012.

01. Nr. 16/17876
Gjilan, më 15.07.2011

Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryeues